



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.20/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës – KDI me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 07.06.2026, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 06.06.2026, merr këtë:

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës – KDI, ZP.Anr.20/2026 e datës 04.06.2026, ashtu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, i shqiptohet dënim më gjobë në lartësi prej 6.000 (gjashtëmijë euro)€.

II. Detyrohet Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 04.06.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën nga Instituti Demokratik i Kosovës – KDI parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në të cilën pretendon se me datë 03.06.2026, subjekti politik LDK ka mbajtur një tubim publik me banorët e fshatit Dobrajë e Madhe në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 07.06.2026 dhe gjatë këtij tubimi, ankuesi pretendon se janë cenuar rregullat e fushatës zgjedhore dhe dizpozitat e LZP-së pasi që monitoruesit e KDI-së kanë raportuar se gjatë këtij tubimi janë hasur një numër i konsiderueshëm i fëmijëve nën moshën 15 vjecare. Tutje parashtruesi i ankesës thekson se nga paraqitja e këtij tubimi publik edhe në media sociale konkretisht në faqet zyrtare të kandidatit për kryeministër nga subjekti politik i lartcekur, Lumir Abdixhiku, shihen disa foto me të mitur dhe grup moshë të reja që duket se janë nën moshën 15 vjecare.

Prandaj, bazuar në këto veprime, parashtruesi i ankesës konsideron se është cenuar neni 5, par.3 i Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për fushatën zgjedhore, monitorimin e fushatës së

zgjedhjeve dhe deklarimin financiar ku në mënyrë shprehimore parashihet se: “Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjec në fushatën zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të behët pa prezencën apo pëlqimin e prindërve”.

Si prova, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur: Fotografitë nga tubimi i LDK-së.

1. <https://www.facebook.com/photo?fbid=10163372319567759!&set=pcb.10163372330897759>

2. <https://www.facebook.com/photo?fbid=10163372319567759!&set=pcb.10163372330897759>

3. <https://www.facebook.com/photo?fbid=10163372319567759!&set=pcb.10163372330897759>

4. <https://www.facebook.com/photo?fbid=10163372319567759!&set=pcb.10163372330897759>

Në përgjigje në ankesë nga subjekti politik LDK theksohet se, fotografitë e bashkangjitura nuk mund të shërbejnë si provë për përcaktimin e moshës së një personi dhe as nuk dëshmojnë nëse personat në fjalë kanë qenë apo jo të shoqëruar nga prindërit ose kujdestarët e tyre ligjorë. Tutje, në përgjigje theksohet se tubimi në fjalë është zhvilluar në një hapësirë publike të hapur, i organizuar në mënyrë të rregullt dhe i lajmëruar paraprakisht të organet kompetente, me prezencë të zyrtarëve policorë gjatë gjithë aktivitetit. Si cdo tubim publik në ambient të hapur, pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë e lirë dhe organizatori nuk ka as kompetencë ligjore dhe as mundësi praktike për të kontrolluar identitetin, moshën apo lidhjen familjarë të secilit person që merr pjesë në aktivitet.

Në përgjigje në ankesë gjithashtu ka theksuar se, dizpozitat që rregullojnë pjesëmarrjen e fëmijëve në fushatë zgjedhore ndalojnë angazhimin e tyre nga subjektet politike, ndërsa LDK pretendon se ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë që në rastin konkret ka pasur një angazhim të tillë dhe në asnjë moment kandidati nuk i ka thirrur personat e paraqitur në fotografi në skenë, nuk u ka dhënë fjalën dhe nuk i ka përfshirë në programin e tubimit dhe nuk u ka caktuar ndonjë rol apo aktivitet në funksion të fushatë zgjedhore. Ka shtuar se, fotografitë e paraqitura tregojnë vetëm situatë të zakonshme ku qytetarë të ndryshëm afrohen pranë kandidatit për të bërë fotografi dhe ky veprim i tillë nuk mund të konsiderohet angazhim në kuptimin e rregulloreve zgjedhore dhe se për me tepër, kandidati nuk ka mundësi ta dij moshën e cdo personi që afrohet për fotografi dhe nuk mund të kërkohet prej tij që në një tubim publik t'i ndaloj qytetarët dhe t'i pyes për moshën e tyre apo të verifikojë se a janë ne shoqërim të prindërve të tyre.

Me tutje ka shtuar se, barra e provës bie mbi ankuesin sepse në rastin konkret nuk është dëshmuar as mosha e personave të paraqitur në fotografi, as mungesa e prindërve apo kujdestarëve të tyre dhe as ndonjë veprim i kandidatit ose subjektit politik që do të përbente angazhim të tyre në fushatën zgjedhore dhe se ky rast nuk mund të barazohet dhe as të trajtohet njësoj me rastet ku pretendohet ose provohet se një kandidat ka thirrur një të mitur në skenë, i ka dhënë rol aktiv në program apo e ka përfshirë në aktivitetin politik, konkretisht rastin e kandidatit të LVV. Andaj, duke u bazuar në këto arsye, LDK kërkon nga PZAP-i që ankesën ta refuzoj si të pabazuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Paneli pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës vëren se nga fotografitë dhe linqet e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndëve, është vërtetuar se, me datë 03.06.2026, subjekti politik LDK ka mbajtur një tubim publik me banorët e fshatit Dobrajë e Madhe në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të datës 07.06.2026 dhe gjatë këtij tubimi janë hasur një numër i konsiderueshëm i fëmijëve nën moshën 15 vjeçare, veprim ky që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën është paraparë që: “Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore”.

Paneli vlerëson se qëllimi i kësaj dispozite është mbrojtja e të miturve nga përfshirja në aktivitete të fushatës zgjedhore nga subjektet politike, dhe se në asnjë rrethanë nuk mund të marrin pjesë në aktivitete zgjedhore.

Paneli, me rastin e vendosjes i shqyrtoi edhe pretendimet në përgjigje në ankesë të subjektit politik se tubimi në fjalë është zhvilluar në një hapësirë publike të hapur, i organizuar në mënyrë të rregullt dhe i lajmëruar paraprakisht të organet kompetente, me prezencë të zyrtarëve policorë gjatë gjithë aktivitetit. Si çdo tubim publik në ambient të hapur, pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë e lirë dhe organizatori nuk ka as kompetencë ligjore dhe as mundësi praktike për të kontrolluar identitetin, moshën apo lidhjen familjarë të secilit person që merr pjesë në aktivitet. Por të njëjtin pretendim e vlerësoi si të pabazuar, për faktin se në momentin kur organizatori i aktivitetit iu ka mundësuar fëmijëve për t'u fotografuar më kandidatët nga radhët e subjektit politik LDK në kuadër të tubimit zgjedhor, pjesëmarrja e tyre konsiderohet përfshirje aktive në fushatë zgjedhore. Sepse për zbatimin e kësaj norme nuk është vendimtare nëse fotografitë e paraqitura tregojnë vetëm situatë të zakonshme ku qytetarë të ndryshëm afrohen pranë kandidatit për të bërë fotografi, por vet fakti se subjekti politik ka lejuar dhe mundësuar pjesëmarrjen e tyre aktive, apo edhe pasive në një aktiviteti zyrtar zgjedhor.

Po ashtu, pretendimi se, në asnjë moment kandidati nuk i ka ftuar personat e paraqitur në fotografi në skenë, nuk u ka dhënë fjalën dhe nuk i ka përfshirë në programin e tubimit dhe nuk u ka caktuar ndonjë rol apo aktivitet në funksion të fushatës zgjedhore. Këto pretendime paneli i vlerëson si të pabazuara, për faktin se nuk është më rëndësi në këtë rast se a ka pasur ftesë, organizim apo koordinim për të marrë pjesë fëmijët në aktivitete politik, por me rëndësi është fakti se organizatori i këtij aktiviteti e ka lejuar që të marrë pjesë në këtë aktivitet politik duke u fotografuar dhe me pas duke i shpërndarë foto në rrjetin social Facebook, veprim ky i cili bje në kundërshtim me Rregulloren e sipërcituar.

Në këtë kuptim, për Panelin këto veprime janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Paneli me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit më gjobë si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: se përfshirja e fëmijëve në fushatë zgjedhore

përbenë shkelje të drejtave të tyre dhe se nuk është në interesin më të mirë të tyre që subjektet politike të angazhohen në fushata zgjedhore, po ashtu paneli ka vlerësuar natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, dhe se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, po ashtu faktin se i njëjti subjekt edhe në një rast tjetër në këto zgjedhje ka kryer të njëjtat veprime me ç'rast edhe i është shqiptuar dënime me gjobë.

Mbi këtë bazë, e duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e subjektit ankues janë të bazuara, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe provave të bashkangjitura nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, të rregullës zgjedhore.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim nenit 118 paragrafi 1, dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.20/2026, datë 06.06.2026

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshillë Juridike: kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovë, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.